



**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Drejtoria e Mbikqyrjes se Tregjeve, Tarifave dhe Sherbimit Postar

Treguesit statistikorë të tregut të komunikimeve  
elektronike

6 Mujori I-rë 2014

Tetor 2014

## **PËRMBAJTJA**

HYRJE .....	3
PANORAMA E PËRGJITHSHME.....	4
1. TREGU CELULAR .....	5
Figura 1.1 Përdorues aktivë dhe SIM karta aktive në periudhën 2010-2014_1.....	5
Figura 1.2. Ecuria e numrit përdoruesve aktive celular në periudhën 2010-2014_1 .....	6
Figura 1.3. Ecuria e numrit të përdoruesve sipas kartave SIM aktive celulare .....	6
Tabela 1.1 Struktura e përdoruesve celulare Kontratë/Parapagim për 2014_1 .....	7
Figura 1.4 Struktura e thirrjeve dalëse celular 2014-1 .....	7
Tabela 1.2. Pjesët e tregut .....	8
Tabela 1.3. Përdorimi mesatar i shërbimit celular 2010-2014_1 .....	9
Figura 1.5. Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë celulare me akses në internet 3G 2012-2014-1 .....	10
2. TELEFONIA FIKSE .....	11
Figura 2.1. Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2014_1 .....	11
Tabela 2.1 Numri i pajtimtarë të telefonisë fikse për periudhën 2010-2014_1 .....	11
3. INTERNETI .....	12
Tabela 3.1 Numri i pajtimtarëve me akses broadband fiks.....	12
Figura 3.1 Numri i pajtimtarëve me akses Broadband nga rrjete Fikse 2010-2014_1 ....	12
Tabela 3.2. Numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G.....	13
Figura 3.2 Ecuria e pajtimtarëve me akses në broadband.....	13
Tabela 3.3. Numri i pajtimtarëve me akses broadband dhe normat e penetrimit .....	13

## HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e publikut, palevë të interesuara dhe të sipërmarrësve të tregut të komunikimeve elektronike me treguesit kryesore të këtij tregu, në vijimësi të raporteve periodike të publikuar në faqen e Internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al) në seksionin “Statistika”, ka përgatitur këtë raport në të cilin publikohen treguesit kryesore të tregut për 6 mujorin e I-rë të vitit 2014 si dhe ndryshimet me periudhat e mëparshme.

-Ky raport është përgatitur duke iu referuar të dhënave të dërguara nga operatorët celularë, Albtelecom si dhe të dhënave të Operatoreve Alternative dhe Ofruesve të shërbimeve, sipas formularëve të Rregullores të të dhënave statistikore, të plotësuar nga sipërmarrësit e autorizuar nga AKEP. Për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave, jo të gjithë treguesit e raportuar nga operatorët publikohen nga AKEP.

Raporti ka natyrë periodike dhe mund të pasurohet edhe me tregues të tjerë apo informacion më të plotë për operatorët alternativë.

## PANORAMA E PËRGJITHSHME

Në 6 mujorin e parë të 2014 sektori i komunikimeve elektronike ka pasur rënie të numrit të pajtimtarëve të telefonisë celulare si në përdorues aktivë edhe në përdorues të kartave SIM aktive, përkatësisht rreth 5.8% dhe 7.2% në krahasim me fund vitin 2013. E njëjta dukuri vërehet edhe tek pajtimtarët e telefonisë fikse, ku reduktimi është rreth 9.2%. Në fund të qershorit të 2014 numri i pajtimtarëve të telefonisë celulare të matur sipas kartave SIM aktive shkoi rreth 4.9 milion nga 5.3 milion që ishte në fund të 2013 dhe numri i pajtimtarëve të matur sipas përdoruesve celularë aktivë (pajtimtarë që kanë përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit) u reduktuar nga 3.7 milion në 3.5 milion. Penetrimi i telefonisë fikse dhe celulare ka qënë përkatësisht rreth 9.2% dhe 123%<sup>1</sup>.

Rritje në 6-mujorin e parë pati numri i pajtimtarëve që përdorin internet nga rrjete fikse dhe rrjetet 3G<sup>2</sup>. Numri i pajtimtarëve me akses broadband fiks dhe celular (3G me karta USB/modem) në fund të Qershorit arriti në rreth 324 mijë, që përbën një rritje me 10.4% në krahasim me fundvitin 2013. Të dy segmentet e aksesit broadband, fiks dhe 3G (me karta USB/modem), kanë pasur rritje me rreth 3.3% dhe 22 % krahasuar me 2013, respektivisht.

---


<sup>1</sup> Matur sipas numrit të përdoruesve aktivë

<sup>2</sup> Këtu merren parasysh numri i pajtimtarëve të telefonisë celulare me akses në Internet broadband UMTS nëpërmjet cards/modems/keys (jo aparate celulare)

## 1. TREGU CELULAR

Numri i përdoruesve të telefonisë celulare që prej 2010 e në vazhdim është matur nga AKEP në dy mënyra, sipas përdoruesve aktivë<sup>3</sup> dhe përdoruesve SIM karta aktive<sup>4</sup>, pra është ndjekur e njëjta metodologji si në publikimin e fundit në Qershor 2014. Figura 1.1 paraqet ecurinë e këtij treguesi, matur sipas dy mënyrave, në harkun kohor 2010-2014\_1.

Figura 1.1 Përdorues aktivë dhe SIM karta aktive në periudhën 2010-2014\_1



Ndërkohë, figurat 1.2 dhe 1.3 paraqesin ecurinë e këtij treguesi të matur me të mënyrat. Referuar figures 1.2 vihet re se numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare në fund të gjashtëmuajorit të parë 2014 ka pësuar një rënie prej rreth 5.8% krahasuar me fundvitin 2013. Kurse, nga figura 1.3 rezulton se për të njëjtën bazë krahasimi, numri i përdoruesve sipas kartave SIM celulare është reduktuar me 7.2%.

<sup>3</sup> Numri i 'përdoruesve aktivë' që janë përdorues të kartave SIM që kanë përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit

<sup>4</sup> Numri i përdoruesve sipas kartave 'SIM aktive' që i referohet numrit të kartave SIM që janë aktive në rrjet celular në fund të periudhës së raportimit

Figura1. 2. Ecuria e numrit përdoruesve aktive celular në periudhën 2010-2014\_1





Figura 1.3. Ecuria e numrit të përdoruesve sipas kartave SIM aktive celulare




Një tregues tjetër që merr në konsideratë AKEP është dhe raporti i përqindjes së përdoruesve me kontratë dhe me parapagim. Ajo që vërehet është fokusimi i politikave të kompanive drejt përdoruesve me parapagim, dukuri kjo e evidentuar edhe më parë. Tabela 1.1 paraqet shpërndarjen në përqindje për secilin operator dhe në total të këtij raporti për 6 mujorin e parë të 2014. Krahasuar me fundvitin 2013, ndryshime të konsiderueshme në strukturën e përdoruesve vërehen tek operatori Plus, ku përdoruesit active kanë ndryshuar nga 44% me kontratë dhe 56% me parapagim në 28% me kontratë dhe 72% me parapagim. Operatorët e tjerë kanë pasur ndryshime të vogla të këtij raporti.

**Tabela 1.1 Struktura e përdoruesve celulare Kontratë/Parapagim për 2014\_1**

	AMC	Vodafone	Albtelecom (EM)	Plus Communication	Total
	Kontratë/Parapagim	Kontratë/Parapagim	Kontratë/Parapagim	Kontratë/Parapagim	Kontratë/Parapagim
Përdorues aktiv	16% / 84%	7% / 93%	23% / 77%	28% / 72%	13% / 87%
SIM aktivë	9% / 91%	6% / 94%	16% / 84%	22% / 78%	9% / 91%

Në figurën 1.4 jepet një paraqitje e strukturese se thirrjeve dalese në përqindje për gjashtëmujorin e parë 2014. Thirrjet on-net janë reduktuar në 87% në krahasim me 93% në vitin 2013.

**Figura 1.4 Struktura e thirrjeve dalëse celulare 2014-1**



Pjesët e tregut gjatë harkut kohor 2010-2014\_1, të matura sipas përdorues aktive, përdorues sipas kartave SIM aktive, përdorues me kontratë, thirrje dalëse dhe SMS, janë paraqitur në tabelën 1.2. Përsa i përket pjesëve të tregut të matura mbi bazë përdoruesish aktivë vërehet se në gjashtëmujorin e parë të 2014 operatorët që kanë ndryshime nga periudha parardhëse janë AMC dhe Vodafone. AMC ka reduktim me rreth 2 pikë përqindje dhe Vodafone ka rritje rreth 2 pikë përqindje krahasuar me fundin e 2013. E kundërta ndodh me pjesët e tregut të matura sipas përdoruesve të kartave SIM aktive për AMC dhe Vodafone, këtu AMC ka rritje dhe Vodafone ka reduktim në krahasim me fundvitin 2013. Dy operatorët e tjerë, Albtelcom(EM) dhe Plus, nuk kanë pësuar ndryshim në pjesë tregu për përdorues në krahasim me 2013. Ndryshime dinamike ka në pjesët e tregut të matura sipas përdoruesve me kontratë. Edhe tek pjesët e tregut të matura sipas thirrjeve dalëse ka ndryshime, por më të moderuara se tek pjesët e tregut për përdorues me kontratë.

Tabela 1.2. Pjesët e tregut

	Viti	AMC	Vodafone	Albtelcom(EM)	Plus Communication
<b>Përdorues Aktivë</b>	2014_1	35%	47%	12%	6%
	2013	37%	45%	12%	6%
	2012	40%	42%	12%	6%
	2011	37%	44%	13%	6%
	2010	44%	36%	19%	1%
<b>Përdorues (Karta SIM)</b>	2014_1	42%	40%	13%	6%
	2013	39%	42%	13%	6%
	2012	33%	36%	25%	5%
	2011	37%	35%	21%	8%
	2010	44%	37%	18%	1%
<b>Përdorues me Kontratë</b>	2014_1	42%	24%	21%	13%
	2013	37%	22%	21%	20%
	2012	31%	18%	36%	15%
	2011	35%	24%	34%	7%
	2010	43%	30%	27%	0%
<b>Thirrje dalëse</b>	2014_1	36%	50%	10%	4%
	2013	39%	51%	7%	3%
	2012	39%	50%	8%	3%
	2011	37%	51%	10%	2%
	2010	46%	45%	9%	-



SMS	2014_1	22%	72%	5%	1%
	2013	21%	73%	5%	1%
	2012	20%	73%	6%	1%
	2011	27%	64%	8%	1%
	2010	34%	57%	9%	-

Tregues tjetër që plotëson kornizën e tregut celular është edhe përdorimi mesatar i shërbimit celular. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është matur sipas thirrjeve dalëse dhe thirrjeve hyrëse, të matura në minuta për një përdorues. Trafiku i marrë për bazë është ai gjeneruar dhe hyrës pjestuar me numrin mesatar të përdoruesve gjate periudhes perkatese. Në trafik të gjeneruar kemi trafikun e origjinuar nga vete përdoruesi dhe në trafikun hyrës kemi trafikun që ka hyrë nga rrjete e tjera plus atë që ka hyrë nga rrjeti i vet.


Sic vihet re nga tabela 1.3 ky tregues për këtë gjashtë mujor ka pasur rritje. Mesatarja e komunikimit mujor për një përdorues(sipas numrit të përdoruesve aktive) për gjysmën e parë të vitit ka qënë rreth 339 minuta dhe 39 SMS të dërguara.

**Tabela 1.3. Përdorimi mesatar i shërbimit celular 2010-2014\_1**

	2011	2012	2013	2014_1	Ndryshimi 2014_1/2013
<b>Përdorues Aktive</b>					
Thirrje dalëse në muaj	130	152	156	169	8%
Thirrje të marra (hyrëse) në muaj	147	168	167	170	2%
MOU	277	320	323	339	5%
SMS (dalëse) në muaj	19	35	39	39	0%
<b>Përdorues Karta SIM</b>					
Thirrje dalëse në muaj	83	93	103	119	16%
Thirrje të marra (hyrëse) në muaj	94	103	111	119	7%
MOU	177	196	214	238	11%
SMS (dalëse) në muaj	12	21	26	28	8%

Përvec ofrimit të shërbimit të telefonisë celulare, është edhe shërbimi broadband në rrjetet e lëvizshme. Aksesit në internet 3G nga aparatet celulare dhe USB/Modem ka evoluar si në figurën 1.5


Figura 1.5. Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë celulare me akses në internet 3G 2012-2014-1



## 2. TELEFONIA FIKSE

Telefonia fikse në 6 mujorin e I-rë të 2014 ka pasur rënie të numrit të pajtimtarëve me rreth 9.2% në krahasim me fundin e 2013.

Figura 2.1. Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2014\_1



Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse për disa nga operatorët kryesorë që veprojnë në treg është dhënë në tabelën 2.1.

Tabela 2.1 Numri i pajtimtarë të telefonisë fikse për periudhën 2010-2014\_1

Viti	Albtelcom	Abcom	ASC	Nisatel	AMC Fiks	OA te tjere	Total
2010	277,763	19,975	7,408	5,900	NA	20,456	331,502
2011	258,943	27,167	10,129	4,950	7,565	30,090	338,844
2012	230,397	33,000	7,649	5,500	6,119	28,996	311,661
2013	210,382	13,680	15,047	7,166	6,950	27,975	281,200
2014_1	196,152	13,800	15,465	8,217	5,994	15,730	255,358
Ndryshimi 2014_1/2013	-7%	1%	3%	15%	-14%	-44%	-9%

### 3. INTERNETI


Shërbim i aksesit në internet ofrohet nga rrjete fikse dhe celulare. Në fund të 6 mujorit të parë 2014 numri i pajtimtarëve me akses broadband ka pasur rritje. Segmenti i aksesit në internet nga rrjetet fikse për disa nga operatorët që kanë ofruar këtë shërbim paraqitet si më poshtë:

Tabela 3.1 Numri i pajtimtarëve me akses broadband fikse

Viti	Albtelecom	Abcom	Abissnet	ASC	OA te tjere	Total Broadband Fiks
2010	70,597	13,575	7,000	5,666	23,162	120,000
2011	60,055	29,321	15,321	10,129	24,871	139,697
2012	66,757	35,870	17,719	11,777	27,965	160,088
2013	73,242	43,430	20,562	15,432	29,890	182,556
2014_1	74,994	44,620	21,680	15,819	31,555	188,668
Ndryshimi 2014_1/2013	2.4%	2.7%	5.4%	2.5%	5.6%	3.3%

Gjatë gjashtëmujorit të parë të 2014 numri i pajtimtarëve me akses broadband nga rrjetet fikse pati një rritje prej 3.3% kundrejt vitit 2013, dhe shumica e operatorëve kanë pasur rritje të numrit të pajtimtarëve. Ecuria e numrit të pajtimtarëve në periudhën 2010-2014\_1 jepet në Figura 3.1.

Figura 3.1 Numri i pajtimtarëve me akses Broadband nga rrjete Fikse 2010-2014\_1




Edhe segment i aksesit broadband nga rrjete celulare 3G ka pasur zhvillime positive, ku numri i pajtimtarëve nëpërmjet cards/modems/keys (jo aparate celulare) u rrit me rreth 22% në krahasim me fundvitin 2013. Numri i përdoruesve me akses broadband 3G nga aparatet celulare është rreth 923 mijë në fund të 6 mujorit të I-rë të 2014, që perben reduktim me 18% në krahasim me vitin 2013. Në total numri i përdoruesve me akses broadband 3G (aparate celulare dhe karta USB) është 1.06 milion. Numri i pajtimtarëve për këtë segment ilustron në tabelën 3.2.

Tabela 3.2. Numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G

Viti	AMC		Vodafone		Albtelecom(EM)		Total	
	Aparat celular	USB/Modem	Aparat celular	USB/Modem	Aparat celular	USB/Modem	Aparat celular	USB/Modem
2012	222,882	17,833	371,426	37,572	NA	NA	594,308	55,405
2013	279,428	32,138	568,207	66,086	272,257	13,143	1,119,892	111,367
2014_1	159,298	58,201	514,696	55,124	248,514	22,521	922,508	135,846
Ndryshimi 2014-1/2013	-43%	81%	-9%	-17%	-9%	71%	-18%	22%

Të dy segmentet bashkë kanë pasur rritje vit pas viti siç ilustron në figurën 3.2. Duhet pasur parasysh që tek pajtimtarët me akses broadband nga rrjeti 3G në figure përfshihen vetëm ata që kanë pasur akses nëpërmjet cards/modems/keys (jo aparate celulare).

Figura 3.2 Ecuria e pajtimtarëve me akses në broadband



Një informacion më i detajuar për segmentin e aksesit në broadband nga të dyja rrjetet e mund të merret nga tabela 3.3, ku jepet në mënyrë të detajuar penetrimi për familje dhe popullsi. Vihet re rritje e penetrimit në të dyja rastet.

Tabela 3.3. Numri i pajtimtarëve me akses broadband dhe normat e penetrimit

Viti	Numri i pajtimtarëve			Penetrimi				
				Popullsi <sup>5</sup>			Familje	
	Rrjete Fiks	Rrjete 3G <sup>6</sup>	Total	Fiks	3G	Fiks + 3G	Fiks	Fiks + 3G
2011	139,697	34,493	174,190	4.90%	1.20%	6.20%	17%	22%
2012	160,088	55,405	215,493	5.70%	2.00%	7.60%	20%	27%
2013	182,556	111,367	293,923	6.40%	3.90%	10.40%	22%	37%
2014_1	188,668	135,846	324,514	6.66%	4.80%	11.46%	26%	45%

<sup>5</sup> Është përdorur numri i popullsisë dhe i familjeve sipas Censurit 2011

<sup>6</sup> Këtu merren parasysh numri i pajtimtarëve të telefonisë celulare me akses në Internet broadband UMTS nëpërmjet cards/modems/keys (jo aparate celulare)